



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 22.02.2013

Nr. 0204-148

PËR: Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS
SË MITROVICËS, Nr.02/06 -1460/11 Pranuar me datë, 11.02.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-04, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 02/06 -1460/11 të miratuar me datë 31.01.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 02/06 -1460/11 Miratohet në Parim Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve në Komunën e Mitrovicës, dhe në pajtim me nenin 27 të Statutit të Komunës vihet në Diskutim Publik.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 22.02.2013
br. 0204-148

Za: Avni Kastrati, Gradonačelnik opštine Mitrovica
Rrustem Musa, Predsedavajući Skupštine opštine Mitrovica

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Mitrovica, br.02/06 -1460/11 Pranu
ar me datë, 11.02.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 02/06 -1460/11 odobreno dana 31.01.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi .

- Odluka br. 02/06 -1460/11 odobrava se u principu uredba o dodeli subvencija u opštini Mitrovica ,i u skladu sa članom 27 Statuta opštine daje se na javnoj diskusiji.


Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06 – 1460/11 dt. 31.01.2013
Mitrovicë

Në pajtim me nenin 12 pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen e lokale (Gaz. e R.K nr. 28 datës 4 qershor 2008), neni 43 paragrafi 3 Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/08 të MEF-it - Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve; nenin 39 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Mitrovicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 31.01.2013 pasi shqyrtoi Draft-rregulloren për ndarjen e subvencioneve, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02/06 – 416/10 dt. 17.01.2013); sjell këtë:

VENDIM

1. MIRATOHET NË PARIM Rregullorja për ndarjen e subvencioneve, dhe në pajtim me nenin 27 të Statutit të Komunës vihet në diskutim publik.
2. Diskutimi publik rreth Rregullores për ndarjen e subvencioneve do të zgjas 14 ditë nga dita e shpalljes së këtij vendimi në tabelën e shpalljeve publike të Komunës dhe ueb faqen e Komunës.
3. Obligohet Kryetari i Komunës të organizojë debat dhe konsultime me qytetarë dhe grupe të interesit rreth rregullores.
4. Obligohet Komisioni Statutar që konform nenit 27 pika d të shqyrtojë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura në diskutimin publik, të përgatisë një raport me vërejtjet e pranuar dhe t'i dorëzohet për miratim Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës.
5. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja (e miratuar në parim) për ndarjen e subvencioneve.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Rustem MUSA

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryetarit të Komunës
- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 Kryetarit të Komisionit Statutar
- 1 x 1 Arkivit